



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:084696
Datë: 29.02.2024
Numri i dokumentit: 05395322

PPP.nr.01/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike “KESco” Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, Ndërtesa Elektro Kosova, Kati i II-të në Prishtinë, kundër debitorit B.L., nga Prizreni, “...”, nr....., duke vendosur për prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.978/2018 të datës 09.11.2018 të lejuar nga përmbaruesi privat Rushit Hoxha nga Prizreni, jashtë seancës dëgjimore, më datë 29.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit, B.L., nga Prizreni, ANULOHET Urdhri përmbarimor, P.nr.978/2018 i datës 09.11.2018 të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha nga Prizreni, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Organi përmbarues, përmbaruesi privat Rushit Hoxha nga Prizreni, me urdhrin për përmbarim, P.nr.979/2018 të datës 09.11.2018, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorit të përmbarimit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike “KESco” Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, Ndërtesa Elektro Kosova, Kati i II-të në Prishtinë, paraqitur kundër debitorit të përmbarimit B.L., nga Prizreni, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, DPZ –, për pagesat në emër të shërbimit me furnizim të energjisë elektrike, për periudhën kohore prej datës 09.05.2013 deri më datë 05.10.2018, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 4,370.61 euro, me kamatë ligjore prej 8% deri në përmbarimin definitiv të kërkesës si dhe shpenzimeve të caktuara të përmbarimit në shumën prej 59.00 euro.

Debitori brenda afatit ligjor, ka paraqitur prapësim, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale e me propozim që të aprovohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të lihet jashtë fuqie urdhri për përmbarim i përmbaruesit privat, për pjesën e parashkruar dhe atë

periudhën 18.08.2017 e tutje dhe të refuzohet si i pa bazuar propozimi për përmbarrim i kreditorit për periudhën kohore të parashkrimit e duke u thirrur edhe në parashkrim të borxhit sipas nenit 360 të LMD-së, e më gjerësisht si në këtë prapësim, derisa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim e me propozim që prapësimi i palës debitore të të refuzohet si i pa bazuar e më gjerësisht si në këtë përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin PPP.nr.286/2018 të datës 03.12.2018, ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e palës debitore, B.L., nga Prizreni, ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim P.nr.979/2018 të datës 09.11.2018 të përmbarruesit privat Rushit Hoxha nga Prizreni, për një pjesë të detyrimit në të holla në shumën prej 2,904.94 euro, kurse për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 1,465.67 euro, e ka refuzuar të pabazuar, duke shfuqizuar e lënë pjesërisht në fuqi urdhrin e lartcekur për përmbarrim lidhur me shumat përkatëse, si dhe ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e përmbarrimit, më gjerësisht ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi kreditori ka paraqitur Ankesë për në Gjykatën e Apelit të Kosovës, dhe përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin e saj, Ac.nr.333/19 të datës 20.01.2020, ka ka aprovuar si të themeltë ankesën e palës kreditore, ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.286/2018 të datës 03.12.2018 sa i përket pikës I të dispozitivit, dhe për këtë pjesë lëndën e ka kthyer të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm, ndërsa mbetet e pa shqyrtuar pika II e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren PPP.nr.286/2018 e datës 03.12.2018, me vërejtje të dhëna si në këtë aktvendim.

Gjykata Themelore në Prizren në rishqyrtim të kësaj çështje përmbarrimore me aktvendimin e saj, PPP.nr.47/2020 të datës 16.03.2020, ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e palës debitore, B.L., nga Prizreni, ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim P.nr.979/2018 të datës 09.11.2018 të përmbarruesit privat Rushit Hoxha nga Prizreni, për një pjesë të detyrimit në të holla në shumën prej 2,904.94 euro, kurse për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 1,465.67 euro, e ka refuzuar të pabazuar, duke shfuqizuar e lënë pjesërisht në fuqi urdhrin e lartcekur për përmbarrim lidhur me shumat përkatëse, si dhe ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e përmbarrimit, më gjerësisht ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi kreditori ka paraqitur Ankesë për në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin e saj, AC.nr.3986/2020 të datës 29.03.2022, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.47/2020 të datës 16.03.2020 dhe çështjen ia ka kthyer të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje, me vërejtjet përkatëse sikurse në aktvendimin në fjalë.

Gjykata Themelore në Prizren në rishqyrtim të kësaj çështje, me aktvendimin PPP.nr.64/2022 të datës 16.05.2022, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbarrimit B.L., nga Prizreni, ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim P.nr.979/2018

të datës 09.11.2018 të përmbauesit privat Rushit Hoxha nga Prizreni, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 3,264.93 euro, në pikën II të dispozitivit e ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin për përmbarim P.nr.979/2018 të datës 09.11.2018 për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 3,264.93 euro, ndërsa e ka lënë në fuqi urdhrin për përmbarim për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 905.42 euro, dhe në pikën e III të dispozitivit ka vendosur që pjesa tjetër e prapësimit e debitorit B.L., nga Prizreni i ushtruar kundër urdhrit për përmbarim, P.nr.979/2018 të datës 09.11.2018 për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 905.42 euro të refuzohet si i pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi kreditori ka paraqitur Ankesë për në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin e saj, AC.nr.4216/2022 të datës 12.12.2023, e ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, dhe e ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.64/2022 të datës 16.05.2022 dhe çështjen ia ka kthyer të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm, me vërejtjet sikurse në aktvendimin në fjalë.

Gjykata Themelore në Prizren, në rishqyrtim të kësaj çështje, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit të Kosovës, në aktvendimin e saj, Ac.nr.4216/2022 të dt.11.12.2023, gjeti se prapësimi i debitorit, është i bazuar dhe atë për këto arsye :

Me shikimin në shkresat e lëndës së përmbaimit, P.nr.979/2018 të Përmbauesit privat, Rushit Hoxha nga Prizreni, gjykata si organ kompetent për vendosje për prapësimet e ushtruar kundër Urdhrave për përmbarim të përmbauesit privat, si në rastin konkret, vërtetoi faktin se kreditoja e përmbaimit, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbaimitin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit gjegjë nga librat afariste – transaksioni i konsumatorit për pagesat e rrymës elektrike dhe atë për shkak të detyrimit të lartë cekur në të holla në shumën gjegjëse e për periudhën gjegjëse kohore dhe i lejuar me Urdhrin për përmbarim, P.nr.979/2018 të dt.9.11.2018 të përmbauesit privat kompetent, si organ i përmbaimit, e me propozim të mjeteve gjegjëse të përmbaimit të parapara në LPP për realizimin e detyrimit në të holla, si në rastin konkret e në kuadër të asaj se mbi çfarë baze juridike, caktohet përmbaimiti, për kushtet ligjore nën të cila caktohet përmbaimiti te propozimet për përmbarim në bazë të një dokumenti të besueshëm të përmbaimit – ekstrakti nga librat afariste, si në rastet bëhet fjalë në nenin 22, 29 par.1 pika 3, 30 dhe 37 të LPP-së derisa për prapësimin si mjet të rregullt juridik në procedurën e përmbaimit, bëhet fjalë në nenin 69 të LPP-së e në të cilin, kurse për shkaqet e parapara e për prapësim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin e besueshëm të përmbaimit – ekstraktin nga librat afariste dhe se nga gjendja e shkresave të lëndës del se pala debitore, nuk ka bërë pagesa të një pas njëshme për secilin vit kalendarik, derisa thënie e palës debitore në prapësimin e tij, janë të bazuara sidomos sa i përket asaj se në rastin konkret, kemi të bëjmë me parashkrimin e detyrimit të kërkuar nga pala kreditore, dhe atë në kuptim të nenit 360 të LMD-së, këto kërkesa parashkruhen në afatin prej 1 (një) viti, dhe atë sipas kësaj del se pjesa e detyrimit në të holla në shumën prej 2,904.94 € për vitet 2013, 2014, 2015 dhe e deri më datën 05.10.2018, kjo pjesë e

detyrimin është parashkruar sepse kreditorja propozimin për përmbardim e ka parashtruar pranë përmbarduesit privat me datën 09.11.2018 ndërsa afati për parashkrimin 1 vjeçar fillon të rrjedh nga fundi i vitit për secilën kërkesë veç e veç, në rastin konkret për detyrimin e lartcekur prej datës 19.05.2013 e deri në vitin 09.11.2016 detyrimi është parashkruar sepse kreditori ka arritur që ta ndal afatin e parashkrimit për kërkesat deri më datën 09.11.2018 duke pas parasysh që kërkesa e datës 09.11.2016 fillon të rrjedhë prej datës 09.11.2017 dhe parashkruhet me datën 09.11.2018, rrjedh se deri më datën 05.10.2018 është ndalur parashkrimi. Nga ku rezulton se pjesa e detyrimit pas datës 05.10.2018 e deri më datë 19.05.2013 është parashkruar pasi që kanë kaluar më shumë se 1 vit prej ditës kur fillon të rrjedh detyrimi për secilën kërkesë veç e veç mujore duke pas parasysh se detyrimi i të paditurës ndaj kreditores është periodik edhe afati i parashkrimit është llogaritur në baza mujore.

Gjykata po ashtu ka vendosur që kjo çështje përmbardimore të përfundoj për këtë pjesë të borxhit, pasi që për detyrimin pas datës 09.11.2016 e deri më datë 09.11.2018, është gjykuar sipas aktvendimit të kësaj Gjykate PPP.nr.286/2018 i datës 03.12.2018, i cili është bërë i plotfuqishëm sipas aktvendimit të Gjykatës e Apelit e Kosovës Ac.nr.333/2019 të datës 20.01.2020.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 73 par.3 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.01/2024

Datë 29.02.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.